

Data \_\_\_\_\_

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbim**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROKURIMIT:**

**Transmetimi GPRS per PDA dhe matesa per nje periudhe 3 vjecare.**

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Sherbimi i GRPS – 64212500 - 0.

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

89.893.800 (Tetedhjetë e nente milion e teteqind e nentedhjetë e tre mijë e teteqind) leke pa TVSH ose 908,202 (Nenteqind e tete mijë e dyqind e dy) euro pa TVSH.

*Sipas kursit zyrtar te dates 17.10.2024*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:**

Kompania OSHEE Group sh.a. kërkon te prokurojë shërbimin e komunikimit M2M (machine to machine) me teknologjinë “GPRS intranet” ose te mëvonshme për të realizuar dërgimin e sigurtë te të dhënave nga pajisjet fundore që kanë të integruara karta SIM në infrastrukturën qendrore kompjuterike, dhe konkretisht:

- Dërgimin e te dhënave nga pajisjet e lexuesve PDA (personal digital assistant) në serverin përkatës pranë zyrave të OSHEE GROUP sh.a.;
- Dërgimin periodik të të dhënave nga matësat inteligjentë (smart metter) në serverët përkatës;
- Komunikimin e tabletave të përdoruesve në terren të pajisura me karta SIM me serverët përkatës.
- Shërbimin e komunikimit M2M (machine to machine) me teknologjinë “GPRS intranet” ose te mëvonshme për të realizuar dërgimin e sigurtë te të dhënave nga pajisjet fundore që kanë të integruara karta SIM në infrastrukturën qendrore kompjuterike.

Operatori Ekonomik duhet të instalojë pajisje rrugëzimi (router) në Zyrat Qëndrore të OSHEE GROUP sh.a., për të realizuar ndarjen e sigurte të infrastrukturës së ofruesit të shërbimit me infrastrukturën kompjuterike të OSHEE GROUP sh.a.

- Ndërfaqja e router-it të ofruesit të shërbimit me infrastrukturën e rrjetit kompjuterik të OSHEE GROUP sh.a. duhet të jetë Ethernet me kapacitet 1 Gbps.
- Operatori Ekonomik duhet të konfigurujë të paktën 10 APN private të dedikuara për OSHEE GROUP sh.a. me emra specifike sipas kërkesës së OSHEE GROUP sh.a. Kartat SIM duhet të lidhen vetëm me APN përkatëse.
- Operatori Ekonomik duhet të sigurojë një lidhje data me fibër optike drejt OSHEE GROUP sh.a. ku të grumbullohet trafiku i gjithë APN. Kapaciteti i lidhjes të jete jo më i vogël se 100 Mbps me mundësi dyfishimi sipas nevojës.
- Operatori Ekonomik duhet të sigurojë transferimin e të dhënave në kohe reale.
- Operatori Ekonomik duhet të vendosë në dispozicion në baze mujore raportin mbi SIM-et që rezultojnë të lidhura me një paisje (device) dhe të dhënat përkatëse mbi volumin e trafikut uplink dhe downlink. Raportet duhet të paraqesin situatën javore.
- Operatori Ekonomik duhet të lajmërojë Autoritetin Kontraktor kur një kartë SIM kalon dyfishin e kapacitetit.
- Disponueshmëria e lidhjes duhet të jetë jo më e vogël se 99.9%.
- Koha e implementimit të shërbimit jo më e madhe se 7 ditë.

**Nisur nga procesi i kompleks i punës dhe infrastruktura që duhet ngritur për zbatimin e kesaj kontrate dhe nga ana e OSHEE GROUP sh.a, kjo procedure nuk mund të ndahet në lote, pasi është e pamundur të ndash përgjegjësitë dhe Kohën e reagimit në rast problemi.**

## **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenin 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike per realizimin e objektit te prokurimit dhe marre persiper çdo rrezik qe mund te ndodhe, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 89.893.800 (Tetëdhjete e nente milion e teteqind e nentëdhjete e tre mijë e teteqind) leke pa TVSH.**

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, ku përcaktohet se: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Lloji i procedurës është “e hapur shërbime – mbi kufirin e lartë monetar” me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma” a” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:” Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

1. dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

**Shënim:** Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit) është Brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohet. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këte procedure eshte gjykuar qe vlera e xhiros se kerkuar te jete minimalisht sa 100% e vleres se parashikuar te kontrates.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, ku përcaktohet se:” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Ndër të tjera, përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke u mbështetur gjithashtu dhe në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përkatësisht në miratimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" ku përcaktohet se: *"Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.2. Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qendrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2021, 2022, 2023. Per të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve gjithashtu të jone të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.**

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", e ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" "përcaktohet se:" Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji".

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: *"Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar*

*standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

*i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh**; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh**; iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël".*

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 35,000,000 (Tridhjetë e pesë milion) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- *Për përvoja të mëparshme të realizuar me sektorin publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.*
- *Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**".*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet të ngjashme të jenë në vlerën jo më shumë se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurueshmërisë që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë nën 40 % e vlerës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do të jetë realisht në gjendje të realizojë kontratën

objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurinë e punës se AK, e cila ka ne funksionim nje seri sistemesh te nderlidhura dhe te informatizuara e teknologjise se larte dhe me impakt shume te madh financiar ne rast bllokimi apo mos-funksionimi.

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare ISO 9001:2015 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) dhe ISO 27001:2013 ose ekuivalente per sistemin e menaxhimit te sigurise se informacionit (e vlefshme).

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

*Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 te VKM-285 date 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

#### **Konkretisht:**

**Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 9001:2015 ose ekuivalent,** na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjëndje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mire të cilësisë.

Përkatësisht kjo lloj ISO specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- Duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.
- Synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat staturore dhe normative të aplikueshme.

**Kërkesa Lidhur me certifikimin ISO 27001:2013** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshëm.

**Theksojme se në të gjitha procedurat ku është vendosur si kërkesë që OE të disponojnë ISO 27001 nga ana e njesisë është përditësuar standarti duke kërkuar ISO 27001:2022 (për konsultimit me fagen zyrtare të DPS), por nga ana e KPP-se nepermjet me vendimin Nr. 376/2024 datë 18.04.2024 është arsyetuar mbështetur edhe në përgjigjen që ka marrë nga DPA (citojme pjesë nga arsyetimi: Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 714/6 prot., datë 08.03.2024 “Kërkesë për 12 informacion” ju informojmë se certifikatat e lëshuara sipas ISO/IEC 27001:2013 nga OVK e akredituar nga DPA, për klientët e tyre, janë të vlefshme deri në datë 31.10.2025. Forumi Ndërkombëta i Akreditimit (IAF) ka vendosur një periudhë tranzitore 3 vite (36 muaj) për kalimin nga standardi ISO/IEC 27001:2013 në standardin ISO/IEC 27001:2022. Referuar dokumentit IAF MD 26:2022, versioni 1, periudha e tranzicionit për standardin ISO/IEC 27001:2022 do të vazhdojë deri në datë 31 tetor 2025) që iso ISO 27001:2013 është e vlefshme gjatë periudhës tranzitore deri në datë 31 tetor 2025.**

**2.3.3** Operatori ekonomik Ofertues duhet të disponojë minimalisht **3 punonjës**, të cilët të jenë të vërtetuar me kontratë individuale pune midis paleve të vlefshme, Çertifikate Perkatëse si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit nga data e hapjes së ofertave, **nga të cilët 2 punonjës të jenë në pjesën teknike të shërbimit** (minimum një punonjës të jetë i pajisur me kartele personale të sigurimit teknik, të lëshuar nga organe kompetente të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001, i ndryshuar dhe të pakten 1 punonjës nga pjesa teknike të jetë i certifikuar për rrjetat kompjuterike i pajisur me certificate CCNA Routing & Switching ose ekuivalente) **dhe një nga pjesa e shitjes së kompanisë.**

*Për të përmbushur këto kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, me njoftimin praparak të fituesit, të gjitha dokumentat e vetëdeklaruar do të dorëzohen pranë AK origjinale ose kopje të noterizuara.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin minimal të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

**Argumentimi teknik:** Punonjësit e më lart përmendur nevojiten për të implementuar shërbimin meqënëse operatorit ekonomik i është kërkuar të instalojë pajisje rrugëzimi (router) në Zyrat Qëndrore të OSHEE GROUP sh.a., për të realizuar ndarjen e sigurtë të infrastrukturës së ofruesit të shërbimit me infrastrukturën kompjuterike të OSHEE GROUP sh.a. dhe parandaluar ndërprerjen e shërbimit në një SIM Card. Në rastin kur për arsye teknike ajo e tejkalon volumin e shërbimit, nisur dhe nga shtimi i kartave në raste emergjente, nevojitet një teknik për zgjidhjen në kohë të avarive të mundshme dhe një person nga pjesa e shitjes për porosinë e kartave.

**2.3.4** Ofertuesi duhet te siguroje një rrjet te qëndrueshëm dhe të sigurtë për transmetimin e të dhënave on line. Kompania në fjalë duhet të ketë mbulim gjeografik te shërbimit, ne jo me pak se 95 % e Territorit të Republikës së Shqipërisë, certifikuar nga institucioni përgjegjës qe mbikëqyr tregun e komunikimeve elektronike, AKEP.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, shkronja ”a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një rrjet te qendrueshem dhe te sigurt për të përmbushur kontratën, duke qene se OSHEE Group sh.a, operon pothuajse ne te gjithë territorin e shqiperise, domozdoshmerisht dhe Kontraktori i mundshem duhet te mbuloje me shërbim territorin, prandaj dhe minimalisht kerkojme me mbulim 95 %.

**2.3.5** Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë për ofrimet e shërbimeve GSM nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, shkronja ”a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kërkesa e mesiperme eshte license e leshuar nga AKEP, qe eshte dhe detyrim ligjor per shërbimin e kerkuar.

**2.3.6** Ofertuesi duhet të garantojë shtimin e kartave SIM deri në 20 % te tyre nëse kërkohet nga OSHEE GROUP sh.a, duke mbajtur të njëjtin volum total të trafikut mujor.

Per te permbushur kete kriter, OE Ofertues duhet te paraqese deklarate te nenshkruar nga Administrator i shoqerise.

***Për të përmbushur këte kriter, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, me njoftimin praparak te fituesit, te gjitha dokumentat e vetedeklaruara do te dorezohen prane AK origjinale ose kopje te noterizuara.***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, shkronja ”a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që nese OSHEE Group sh.a, ne raste emergjente do ti nevojiten SIM Card shtese, kerkohet qe SIM Cart te vihen ne dispozicion deri ne dyfishimin e tyre.

**Argumentimi teknik:** Nëse OSHEE Group sh.a, në raste emergjente do ti nevojiten SIM Card shtesë, kërkohet që SIM Card të vihen në dispozicion nga operatori ekonomik.



## **Argumentimi i specifikimeve dhe termave te references**

*Shënim: specifikimet teknike, për shërbimin objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe të pajisjeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”, janë pjese ne DST e kesaj procedure.*

*Në specifikimet teknike, objekti i kontratës, nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.*

***Shënim:** në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në mbështetje të përcaktimit të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që **“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,** autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të plotesoje sa mesiper.*